



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

SKEMË VLERËSIMI

HISTORI

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1 **A** **1 pikë**

Pyetja 2 **B** **1 pikë**

Pyetja 3

Model përgjigjeje

a)

Demokracia athinase para Perikliut	Demokracia athinase gjatë Perikliut
- Në institucione merrnin pjesë vetëm shtresat e larta të popullsisë	- Për herë të parë gjatë qeverisjes së Perikliut u vendosën pagesat nga shteti për njerëzit që punonin në institucione.
- Njerëzit e varfër nuk kishin mundësi monetare për të marrë pjesë në shfaqje të ndryshme	- U krijua një fond i veçantë (Teorikon) për tu mundësuar njerëzve të thjeshtë pjesëmarrje nëpër teatro.
- Funksionin formalisht gjyqi i Popullit, këshilli i të 400-ëve etj	- Krijoi këshillin e 10 Strategëve si një organ mbështetës për demokracinë që ai kishte në plan të aplikonte
- E drejta e fjalës dhe e mendimit ishte më e kufizuar	- U zgjerua e drejta e fjalës dhe e mendimit nëpërmjet ligjit grafe paranamon (shkruar sipas të drejtës që të jep ligji)

- b) Ishte demokraci e kufizuar sepse qytetarë me të drejta politike quheshin vetëm 10% e popullsisë: qytetarët e Athinës; qytetarët e lirë dhe banorë të Athinës (nga nëna dhe babai). Të tjerët jo qytetarë ishin të huajt, sklevërit dhe gratë të cilët nuk kishin të drejta politike. Në mbledhjet e Eklesisë (Kuvendi i qytetarëve) merrnin pjesë vetëm shtresat e pasura. Gratë nuk kishin të drejtë të votonin. Ekzistenca e skllavërisë shihej si një fenomen i natyrshëm.

- 4 pikë** Nëse jep tre nga ndryshimet dhe argumentin pse demokracia ishte e kufizuar.
OSE
- 3 pikë** Nëse jep dy nga ndryshimet dhe argumentin pse demokracia ishte e kufizuar **OSE** jep tre nga ndryshimet.
- 2 pikë** Nëse jep një nga ndryshimet dhe argumentin pse demokracia ishte e kufizuar **OSE** jep dy nga ndryshimet.
- 1 pikë** Nëse jep një nga ndryshimet **OSE** argumentin pse demokracia ishte e kufizuar.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë
Pyetja 8	B	1 pikë
Pyetja 9	C	1 pikë
Pyetja 10	D	1 pikë
Pyetja 11	D	1 pikë

Pyetja 12

Model përgjigjeje

Dy detyrat që shtroi Luteri për përhapjen e tezave të tij ishin:

- Nxitja e arsimit të popullsisë, që mesazhet e tij të kuptoheshin nga masa e gjerë e popullit;
- Përkthimi i Biblës në gjuhën amtare të çdo vendi.

- 2 pikë** Nëse jep dy detyrat që shtroi Luteri.
OSE
- 1 pikë** Nëse jep një nga detyrat që shtroi Luteri.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	A	1 pikë

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

- Ruajtja e tërësisë territoriale të trojeve shqiptare nga synimet shoviniste të fqinjëve.
- Formimi i shtetit kombëtar shqiptar të mirëorganizuar dhe bashkëkohor.
- Zgjidhja e çështjes së arsimit shqip dhe përdorimi i shqipes në administratë.
- Reforma të thella për zhvillimin e vendit.

4 pikë Nëse rendit katër nga kërkesat.

OSE

3 pikë Nëse rendit tri nga kërkesat.

2 pikë Nëse rendit dy nga kërkesat.

1 pikë Nëse rendit një nga kërkesat.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16**Model përgjigjeje**

- a) Iluministi është Monteskjë
- b) Dy idetë janë:
 - ndarja e pushteteve (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor);
 - nëse nuk ndodh ndarja e pushteteve, atëherë kalohet në diktaturë.

3 pikë Nëse identifikon iluministin dhe zbërthen dy idetë kryesore të paragrafit.

OSE

2 pikë Nëse identifikon iluministin dhe zbërthen një nga idetë kryesore të paragrafit.

1 pikë Nëse identifikon iluministin **OSE** zbërthen një nga idetë kryesore të paragrafit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17**Model përgjigjeje**

- Ngjarja është: vrasja e princit trashëgimtar të perandorisë austro-hungareze nga një fanatik serb. Fillimi i Luftës I Botërore.

Shkaqet:

- rindarja e re e botës;
 - përplasjet që u shfaqën në Ballkan (2 luftrat ballkanike përshpjetuan fillimin e Luftës I Botërore);
 - kristalizimi i dy blloqeve (Antanta dhe Blloku Qendror);
 - konfliktet franko gjermane apo austrohungareze-ruso;
 - nacionalizmi ekstrem;
 - irredentizmi etj.
-

3 pikë Nëse identifikon ngjarjen dhe jep dy nga shkaqet.

OSE

2 pikë Nëse identifikon ngjarjen dhe jep një nga shkaqet.

1 pikë Nëse identifikon ngjarjen.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nëse nxënësi jep një nga shkaqet, pa identifikuar ngjarjen, do të vlerësohet me 0 pikë.

Pyetja 18 **A** **1 pikë**

Pyetja 19 **C** **1 pikë**

Pyetja 20 **B** **1 pikë**

Pyetja 21 **A** **1 pikë**

Pyetja 22

Model përgjigjeje

Disa prej karakteristikave që bënë të mundur këtë ecuri ekonomike shumë pozitive, që vazhdon edhe sot, janë:

- në fillesat e rimëkëmbjes ekonomike, një rol shumë të rëndësishëm luajti plani Marshall që ofroi burime financiare për investime;
- marrëdhëniet industriale mes punëdhënësve, punëmarrësve dhe shtetit që bashkëpunojnë ngushtë nëpërmjet prezencës në këshilla të përbashkët që i jep mundësi punonjësve të marrin pjesë në vendimmarrje;
- edhe marrëdhëniet mes shtetit dhe aktorëve të tjerë bazohen në arritjen e konsensusit. Gjithashtu kjo gjë aplikohet edhe në marrëdhëniet mes kompanive;
- arsimi profesional dhe trajnimi lejon formimin e punonjësve për pozicione të specializuara;
- lidhja e sistemit financiar me atë industrial që promovon marrëdhëniet afatgjata me ndikim pozitiv në shëndetin e kompanive të ndryshme dhe jo thjeshtë rendjen pas fitimit nga ana e sektorit financiar;
- disiplina e lartë, si pjesë e kulturës së punës në Gjermani.

3 pikë Nëse jep tre nga tiparet kryesore të modelit ekonomik gjerman.

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga tiparet kryesore të modelit ekonomik gjerman.

1 pikë Nëse jep një nga tiparet kryesore të modelit ekonomik gjerman.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23

Model përgjigjeje

Totalitarizmi në Rusi		Totalitarizmi në Gjermani
Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
Ideologjia komuniste e bazuar mbi kombinimin shoqëri pa klasa + totalitarizëm	Ekzistenca e një partie të vetme bazuar mbi monopolizimin e pushtetit	Ideologjia naziste e bazuar mbi kombinimin nacionalizëm ekstrem + shtet autoritar
Internacionalizëm dhe ekspansion ideologjik.	Sundim diktatorial bazuar mbi ushtrimin e terrorit	Ekspansion territorial bazuar në pushtime dhe luftëra.
Sistem ekonomik i centralizuar dhe e planifikuar bazuar vetëm mbi pronën shtetërore dhe kolektive	Kulti i individit të udhëheqësit	Sistem ekonomik i bazuar mbi bashkimin e biznesit dhe shtetit dhe kontroll të këtij te fundit mbi ekonominë.
Një shoqëri pa diskriminim racor		Besim në një race dhe komb superior .

3 pikë Nëse jep dy tipare dalluese dhe një tipar të përbashkët.

OSE

2 pikë Nëse jep një tipar dallues dhe një tipar të përbashkët OSE dy tipare dalluese.

1 pikë Nëse jep një tipar dallues OSE një tipar të përbashkët.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24

Model përgjigjeje

Republika IV	Republika V
Republikë parlamentare.	Republikë gjysmë – presidenciale.
Sistem elektoral proporcional.	Sistem elektoral maxhoritar.
Presidenti zgjidhet nga parlamenti.	Presidenti zgjidhet nga populli me votim të drejtpërdrejtë.
Kryeministri dhe ministrat emërohen nga parlamenti.	Kryeministri dhe ministrat emërohen nga presidenti.
Ministrat mund të ishin deputete.	Ministrat nuk mund të jenë deputet.
Parlamenti me fuqi të plota.	Parlamenti me fuqi të dobësuar legislative.
Presidenti nuk mund të shpërndante parlamentin	Presidenti mund ta shpërndante parlamentin.

2 pikë Nëse jep dy nga dallimet në aspektin konstitucional;

OSE

1 pikë Nëse jep një nga dallimet në aspektin konstitucional;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25**Model përgjigjeje**

- Presidenti ishte kryetar i qeverisë dhe kontrollonte të gjitha pushtetet.
- Presidenti kontrollonte ekzekutivin, pasi emëronte dhe shkarkonte ministrat.
- Presidenti kontrollonte edhe pushtetin legjislativ, pasi shpërndante parlamentin, vendoste veton për ligjet, caktonte zgjedhjet e reja, emëronte kryetarin e Senatit dhe 6 senatorë.
- Presidenti kontrollonte edhe pushtetin gjyqësor, pasi emëronte gjyqtarët dhe prokurorët.
- Gjithashtu ishte komandant i Forcave të Armatosura dhe emëronte e shkarkonte oficerët e lartë.

4 pikë Nëse jep katër nga të mësipërmet.

OSE

3 pikë Nëse jep tre nga të mësipërmet.

2 pikë Nëse jep dy nga të mësipërmet.

1 pikë Nëse jep një nga të mësipërmet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26**Model përgjigjeje**

a) Vendimet e marra në Mukje ishin:

- krijimi i një Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë ku do të kishte përfaqësues në mënyrë të barabartë si nga FNC dhe nga Balli Kombëtar;
- luftë e përbashkët kundër pushtuesit përkrah aleatëve të Kombeve të Bashkuara, për një Shqipëri etnike, të lirë e demokratike;
- forma e regjimit do të vendosej pas Luftës me zgjedhje të lira e demokratike;

b) PKSHE i hodhi poshtë këto vendime sepse:

- nuk pranonte të ndante pushtetin me forca të tjera politike;
- të nxitur nga jugosllavët nuk pranonte vendimin për një Shqipëri etnike (ku përfshihej edhe Kosova).

3 pikë Nëse jep një nga vendimet e marra në Mukje dhe shpjegon dy arsyt pse PKSHE i hodhi poshtë këtë marrëveshje.

OSE

2 pikë Nëse jep një nga vendimet e marra në Mukje dhe shpjegon një nga arsyt pse PKSHE i hodhi poshtë këtë marrëveshje.

1 pikë Nëse jep një nga vendimet e marra në Mukje **OSE** shpjegon një nga arsyt pse PKSHE i hodhi poshtë këtë marrëveshje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 27**Model përgjigjeje****a)**

- Në aspektin e pronës: kushtetua e vitit 1946 njihete të drejtën e pronës private dhe trashëgiminë e saj. Kushtetuat e vitit 1976, e ndalonte pronën private.
- Në aspektin ekonomik: në kushtetutën e vitit 1946 tregtia me jashtë **kontrollohej** nga shteti, ndërsa në kushtetutën e vitit 1976, ishte **monopol** i shtetit.
- Në aspektin fetar: kushtetua e vitit 1946 njihete të drejtën e ushtrimit të lirë të fesë dhe mb rojten e komuniteteve fetare, ndërsa kushtetua e vitit 1976 e ndalonte fenë dhe e shpallte vendin ateist.

3 pikë Nëse bën krahasimin midis dy kushtetutave në tre aspekte.

OSE

2 pikë Nëse bën krahasimin midis dy kushtetutave në dy aspekte.

1 pikë Nëse bën krahasimin midis dy kushtetutave në një aspekt.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

b) Pasojat

- ndalimi i pronës private, bëri që të mos kishte konkurrencë në treg;
- tregtia e jashtme u bë monopol u shtetit,
- kriza ekonomike e vitit 1980, etj.

2 pikë Nëse jep dy nga pasojat ekonomike të kushtetutës së vitit 1976;

1 pikë Nëse jep një nga pasojat ekonomike të kushtetutës së vitit 1976;

OSE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 **B** **1 pikë**

Pyetja 29 **D** **1 pikë**

Pyetja 30 **C** **1 pikë**

Pyetja 31 **A** **1 pikë**

Pyetja 32**4 pikë**

- Nxënësi tregon një të kuptuar të qartë/plotë të temës/problematikës.
- Zhvillon të gjitha aspektet e temës/problematikës, madje edhe në thellësi.
- Është më shumë analizuese sesa përshkuese.
- Mbështetet në **shumë** fakte konkrete, shembuj specifikë dhe detaje.
- Demonstron një organizim logjik të argumentimit të temës.

3 pikë

- Zhvillon të gjitha aspektet e temës/problematikës, por përciptazi.
- Është më shumë përshkuese se analizuese.
- Përfshin **disa** fakte konkrete, shembuj dhe detaje; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla.
- Demonstron një organizim të kënaqshëm të argumentimit të temës.

2 pikë

- Zhvillon minimalisht aspektet e temës/problematikës.
- Është më shumë përshkuese, përfshin pak fakte, shembuj; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla.
- Përfshin **pak** fakte konkrete, shembuj dhe detaje; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla.
- Demonstron një organizim të paqartë të temës.

1 pikë

- Zhvillon aspektet minimale të temës/problematikës.
- Nuk përmban analizë.
- Përfshin disa fakte konkrete, shembuj dhe detaje; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla.
- Demonstron një organizim të paqartë, nuk ka një lidhje logjike midis paragrafëve.

0 pikë

- Dështon në argumentimin e temës OSE nuk përfshin fakte OSE përfshin temën, OSE është e pakuptueshme OSE nuk shkruan asnjë fjalë.